

LIGJ
Nr. 8388, datë 5.8.1998
PËR GRUMBULLIMIN E ARMËVE DHE MUNICIONEVE LUFTARAKE
(Ndryshuar me Ligjin nr. 8583, datë 1.3.2000)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Me këtë ligj rregullohen dorëzimi vullnetar, grumbullimi i detyrueshëm, regjistrimi i armëve dhe i municionit luftarak që mbahet pa lejë, si dhe përcaktohen masat që u shërbejnë forcimit të rendit publik dhe parandalimit të krimeve.

Neni 2
Parimet e procesit të grumbullimit të armëve

Procesi i grumbullimit të armëve respekton mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut dhe shoqërohet me sensibilizimin e opinionit, për të siguruar mirëkuptimin ndërmjet shtetasve dhe forcave politike për arritjen e qëllimeve të këtij ligji.

KREU II
KOMISIONET PËR GRUMBULLIMIN E ARMËVE

Neni 3
Komisioni Qendror për Grumbullimin e Armëve
(Ndryshuar fjalë, shtuar togfjalësh dhe hequr rrjesht me Ligjin nr. 8583, datë 1.3.2000)

Për të realizuar procesin e grumbullimit të armëve në Republikën e Shqipërisë krijohet Komisioni Qendror për Grumbullimin e Armëve, me këtë përbërje:

- Zëvendëskryeministri	kryetar
- ministri i Rendit Publik	zëvendëskryetar
- ministri i Mbrojtjes	anëtar
- Ministri i Pushtetit Vendor	anëtar
- kryetari i SHIK -ut	anëtar
- shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë	anëtar
- drejtori i përgjithshëm i policisë	anëtar

Neni 4

Komisionet e prefekturave për grumbullimin e armëve

Pranë çdo prefekturë krijohen komisionet e prefekturave për grumbullimin e armëve, me këtë përbërje:

- | | |
|--------------------------------------|--------------------|
| - prefekti | - kryetar |
| - drejtorët e policisë në prefektura | - zëvendëskryetarë |
| - kryetarët e këshillave të rretheve | - anëtarë |
| - kryetarët e bashkive | - anëtarë |
| - komandantët e njësive ushtarake | - anëtarë |

Neni 5

Komisionet lokale për grumbullimin e armëve

Komisionet e prefekturave për grumbullimin e armëve, nisur nga shtrirja dhe problemet që duhen përballuar në procesin e grumbullimit të armëve, krijojnë komisione lokale të grumbullimit të armëve pranë njësive tokësore-administrative më të vogla, nën juridiksionin e prefekturës që mbulohet prej tyre.

Anëtarët e komisioneve lokale caktohen nga prefekti, duke ndjekur, ku është e mundur, po atë strukturë të komisioneve të prefekturës.

Komisionet lokale raportojnë përpara komisionit të prefekturës.

Neni 6

Detyrat e Komisionit Qendror për grumbullimin e Armëve

Komisioni Qendror për Grumbullimin e Armëve ndjek në vazhdimësi procesin e grumbullimit të armëve dhe jo më pak se një herë në muaj analizon punën e bërë. Ai funksionon në bazë të rregullores së punës, e cila duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave jo më vonë se 2 javë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Komisioni Qendror për Grumbullimin e Armëve, në bashkëpunim me qeverinë organet e pushtetit lokal, organet e forcave të armatosura, organizatat joqeveritare dhe ato ndërkombëtare organizon fushata mbarëkombëtare për sensibilizimin dhe grumbullimin vullnetar të armëve dhe municionit luftarak. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjorë për organizimin e këtyre fushatave.

Komisioni Qendror për Grumbullimin e Armëve nxjerr vendime dhe udhëzime të detyrueshme për komisionet e prefekturave dhe ato lokale.

Neni 7

Raportimet e Komisionit Qendror për Grumbullimin e Armëve

Komisioni Qendror për Grumbullimin e Armëve informon, të paktën një herë në çdo 2 muaj Këshillin e Ministrave, me një raport të shkruar, për ecurinë e procesit, për sasinë dhe llojin e armëve dhe municioneve luftarake të grumbulluara, dhe për problemet që dalin.

Kuvëndi Popullor mund të thërrasë në çdo kohë për raportim krjetarin e Komisionit Qendror për Grumbullimin e Armëve, për ta informuar për ecurinë e procesit të grumbullimit të armëve.

Raportet e Komisionit Qendror për Grumbullimin e Armëve bëhen publike në organet e medias.

Neni 8

Detyrat e komisionit të prefekturës për grumbullimin e armëve

Komisioni i prefekturës ndjek në vazhdimësi procesin e grumbullimit të armëve dhe, jo më pak se një herë në muaj, raporton pranë Komisionit Qendror për Grumbullimin e Armëve.

Në bazë të udhëzimeve dhe të vendimeve të Komisionit Qendror për Grumbullimin e Armëve, komisionet e prefekturës organizojnë fushata për sensibilizimin dhe për grumbullimin vullnetar të armëve dhe të municioneve.

Komisioni i prefekturës, në bashkëpunim me kormisionet lokale, përcakton grafikun e shkeljes së terrenit nga sektori i policisë për grumbullimin e armëve.

KREU III

GRUMBULLIMI I ARMATIMIT DHE SEKTORI I POLICISË PËR GRUMBULLIMIN E ARMËVE

Neni 9

Sektori i policisë së rendit për grumbullimin e armëve

Krijohet sektori i policisë për grumbullimin e armëve në varësi të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë në Ministrinë e Rendit Publik

Sektor i policisë për grumbullimin e armëve krijohet edhe pranë drejtorive të policisë në prefektura, si dhe në komisariatet e policisë, nën juridiksionin e prefekturës.

Sektorët e policisë për grumbullimin e armëve janë pjesë përbërëse e policisë së rendit.

Neni 10

Detyrat e sektorit të policisë për grumbullimin e armëve

Sektori i policisë për grumbullimin e armëve ka për detyrë grumbullimin vullnetar dhe të detyrueshëm të armatimit. Në kryerjen e kësaj detyre ai do të mbështetet edhe nga sektorët e tjerë të policisë, si dhe nga policia ushtarake.

Grumbullimi i armëve dhe i municionit mbetet detyrë parësore e të gjithë sektorëve të policisë së rendit, pavarësisht nga krijimi i sektorit të policisë për grumbullimin e armëve.

Sektori i policisë për grumbullimin e armëve dhe municionit luftarak bashkëpunon dhe kërkon ndihmë nga organet e pushtetit lokal.

Neni 11

Detyrat operative të sektorit të policisë së rendit për grumbullimin e armëve

Punonjësi i sektorit të policisë për grumbullimin e armëve u bën thirrje shtetasve për dorëzimin vullnetar të armëve dhe, kur ka të dhëna të bazuara, ushtron kontroll në banesa ose lokale mbi persona sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Në raste të veçanta sektori i policisë për grumbullimin e armëve mund të kërkojë nga personat, të cilëve u bëhet thirrje për dorëzim vullnetar të armatimit, të deklarojnë me shkrim nëse mbajnë ose jo pa leje armë dhe municione.

Personat që pengojnë ose kundërshtojnë policinë për grumbullimin e armëve, për zbatimin e detyrave të përmendura më sipër, ndëshkohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 12

Roli i policisë ushtarake

Policia ushtarake kryen detyra në interes të zbatimit të këtij ligji, për grumbullimin e armëve dhe të municionit.

Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Rendit Publik, me udhëzim të përbashkët, përcaktojnë rolin dhe detyrat e policisë ushtarake, në mbështetje të sektorit të policisë për grumbullimin e armëve.

Neni 13

Bashkëpunimi me organet shtetërore dhe shtetasit

Organet shtetërore, ato të pushtetit lokal dhe shtetasit, kur marrin dijeni për vendndodhjen e armëve dhe të municioneve, që mbahen pa leje, janë të detyruar të njoftojnë sektorin policisë për grumbullimin e armëve, si dhe çdo sektor të policisë.

Personat që informojnë për sasi të mëdha armësh dhe municioni të fshehur, kur ky informim rezulton i saktë, shpërblehen. Kushtet për verifikimin, si dhe masa e shpërblimit do të vendosen nga Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 15 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji

Neni 14

Bashkëpunimi me komisionet e prefekturës

Policia për grumbullimin e armëve, gjatë veprimtarisë së vet, mban parasysh grafikun përcaktuar nga komisioni i prefekturës për shkeljen e terrenit, si dhe sinjalizimet dhe kërkesat e organeve të pushtetit lokal dhe të shtetasve.

Armët dhe municioni i grumbulluar dorëzohen brenda 24 orëve në njësinë ushtarake të përcaktuar nga komisioni i prefekturës sipas udhëzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 15

Grumbullimi i armëve dhe i municionit

Ministria e Mbrojtjes, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ngarkohet t'i nxjerrë udhëzimet e nevojshme për njësitë ushtarake lidhur me detyrat e tyre për pranimin, ruajtjen dhe administrimin e armëve dhe të municionit të grumbulluar nga dorëzimi vullnetar, nga sektori i policisë për grumbullimin e armëve dhe nga policitë e tjera. Ministria e Mbrojtjes informon, rregullisht, Komisionin qendror për sasinë dhe për llojin e armëve dhe të municionit të grumbulluar.

KREU IV

REGJISTRIMI I ARMËVE TË MBAJTURA PA LEJE DHE PAJISJA ME ARMË

Neni 16

Personat që përfitojnë të drejtën për regjistrimin e armëve dhe pajisjen me armë

Të drejtën për t'u pajisur me armët që mbajnë pa leje, pasi t'i kenë regjistruar ato, paraprakisht dhe në mënyrë vullnetare, si dhe të drejtën për t'u pajisur me armë sipas këtij ligji, e përfitojnë personat si vijon:

a) Drejtuesit dhe ortakët e shoqërive tregtare, vendase a të huaja, të regjistruar në gjykatat shqiptare, që zotërojnë kapital të konsiderueshëm.

b) Banorët e zonave kufitare, tokësore, që paraqesin probleme lidhur me rendin dhe sigurinë publike.

Këshilli i Ministrave përcakton llojin e armës, sasinë e municioneve dhe kriteret lidhur me masën e kapitalit të shoqërive tregtare, zonat kufitare, zonat me probleme për rendin e

sigurinë publike, personat që mund të mbajnë armë me leje, si dhe tarifat për mbajtjen e armëve.

Neni 17

Procedura e regjistrimit

Personat e përmendur në nenin 16 të këtij ligji, duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim, në dy kopje. Njëra kopje e kërkesës i drejtohet këshillit lokal dhe tjetra komisarariatit të policisë.

Personat e përmendur në gërmën "a" të nenit 16, bashkë me kërkesën duhet të paraqesin edhe dëshmi bankare, vërtetim të lëshuar nga zyra e tatimeve dhe e taksave, si dhe dëshmi penaliteti.

Personat e përmendur në gërmën "b" të nenit 16, bashkë me kërkesën duhet të paraqesin dëshminë e penalitetit dhe vërtetimin e lëshuar nga këshilli i komunës ku banojnë.

Në rastin e personave që mbajnë armë pa leje, pas paraqitjes së kërkesës, komisarati i policisë i lëshon atij leje armëmbajtjeje të përkohshme, e vlefshme jo më shumë se 15 ditë.

Leja për të mbajtur armët jepet me vendimin e komisarariatit të policisë, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pasi merr edhe mendimin e këshillit lokal, duke çmuar nëse personi përmbush kushtet e nenit 16, si dhe duke gjykuar, në tërësi, personalitetin e kërkuarit.

KREU V

DORËZIMI VULLNETAR

Neni 18

Përfshirja nga ndjekja penale

Përfshihen nga ndjekja penale për armëmbajtje pa leje personat që, sipas këtij ligji, dorëzojnë vullnetarisht armët që mbajnë pa leje.

Në çdo rast, nuk përfshihen nga ndjekja penale për armëmbajtje pa leje personat që kanë kryer vepra penale duke përdorur si mjet për këtë qëllim armë dhe municion.

Neni 19

Dorëzimi vullnetar

Me dorëzim vullnetar të armëve dhe të municionit do të kuptohet shprehja e vullnetit të lirë, me shkrim ose me gojë, përpara sektorit të policisë për grumbullimin e armëve ose organeve të tjera të forcave të armatosura, për dorëzimin e armëve dhe të municionit që mbahet pa leje.

Sektori i policisë për grumbullimin e armëve vendos, rast pas rasti, mënyrën se si do të bëhet dorëzimi fizik i armëve të deklaruar vullnetarisht, sipas paragrafit të mësipërm.

Në rastet kur dorëzimi fizik i armëve do të bëhet nga vetë personi që ka deklaruar vullnetin për ta dorëzuar, pas përpilimit të deklarimit dhe mbajtjes së një procesverbali, personi në fjalë pajiset me një dokument, të vlefshëm jo më shumë se 12 orë nga çasti i lëshimit, me anë të të cilit ai autorizohet dhe udhëzohet ta lëvizë armën ose municionin nga vendi ku ndodhet për në njësinë më të afërt të forcave të armatosura.

Kur janë sasi të mëdha armësh dhe municioni, personi që ka shprehur vullnetin për dorëzimin e tyre duhet të shoqërohet nga punonjësi i sektorit të policisë për grumbullimin e armëve.

Neni 20

Detyrimi për pranim dhe regjistrimi i armatimit

Personat që dorëzojnë vullnetarisht armët dhe municionet kanë të drejtë t'i dorëzojnë ato në njësinë më të afërt të forcave të armatosura ose në komisariatit më të afërt të policisë. Të gjitha njësitë e forcave të armatosura dhe komisariatet e policisë janë të detyruara të pranojnë, në çdo rast, armët apo municionet që u dorëzohen vullnetarisht nga shtetasit, duke mbajtur për këtë procesverbalin përkatës, si dhe duhet të njoftojnë menjëherë sektorin e policisë për grumbullimin e armëve. Procesverbali bëhet në dy kopje, nga të cilat njëra i jepet personit që dorëzon armët.

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të japë udhëzimet e nevojshme për përcaktimin e njësive më të afërta të forcave të armatosura me dorëzuesit e armëve. Këto udhëzime i bëhen të ditura edhe Komisionit Qendror për Grumbullimin e Armëve, komisioneve të prefekturave, si dhe komisioneve lokale.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

Sanksionet për kundërshtimin e procesit të çarmatimit

Çdo veprim për të penguar apo kundërshtuar organet kompetente në ushtrimin e detyrës së tyre në zbatim të këtij ligji, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 100 000 lekë ose me burgim deri në 6 muaj.

Neni 22

Caktimi i fondeve

Këshilli i Ministrave, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të caktojë fondet e nevojshme për përballimin e shpenzimeve për krijimin e sektorit të policisë për grumbullimin e armëve, si dhe të shpenzimeve të tjera, të nevojshme për kryerjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 23

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 24

Fuqia e ligjit në kohë

Ky ligj do të jetë në fuqi dhe do të sjellë efekte juridike për një afat prej një viti kalendarik.

Neni 25

Hyrja në fuqi e ligjit

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin nga Presidenti i Republikës.

**Shpallur me dekretin nr.2185, datë 11.8.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

